**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)**
**IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

04.03.19
01-060-12084

**Komuna / Opština: Drenas  Data / Datum: 11/03/2019**

**Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini:** 2

**Takim i rregullt / Redovni sastanak** ☒ **Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak** ☐

**Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 16**

**A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së?**
**Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?**

Po / Da ☐
Jo / Ne ☐
Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒

**A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së?**
**Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?**

Po / Da ☒ *KFOR-LMT9 dhe OSCE.*
Jo / Ne ☐

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë*
*Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

**A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo Nënkryetari?**
**Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?**

Po / Da ☒
Jo / Ne ☐

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**

1. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të KKSB-së, dhe diskutim për rastin i cili ishte tema kryesore e mbledhjes së mbajtur më 07.02.2019;
2. Draft plani i punës së KKSB-së për punën e vitit 2019;
3. Draft orari i punës së KKSB-së për vitin 2019;
4. Diskutim lidhur me shqetësimet e qytetarëve rreth vjedhjeve të shtëpive;
5. Diskutim lidhur me shqetësimet e qytetarëve në lidhje me qentë endacakë;
6. Diskutim lidhur me zjarret fushore dhe malore.
7. Të ndryshme.

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

**Konkluzionet / Zaključci:**

1. Në mungesë të kryetarit Lladrovci, Sylaj e kryesoi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, pastaj pyeti nëse dikush ka për të shtuar diçka sa i përket rendit të ditës, hodhi në votim rendin e ditës i cili u aprovua. Po ashtu edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa ndonjë vërejtje.

2. Edhe pika e dytë e rendit të ditës u aprovua unanimisht pa pasur ndonjë gjë për të shtuar.

3. Ndërsa sa i përket pikës së tretë me marrëveshje u vendos që ditët kur do të mbahen mbledhjet e ardhshme të KKSB-së të jenë ditët si në vijim: e martë për muajin prill (30), e mërkurë për qershor (26), e enjte për muajin gusht (29) dhe prapë e martë për tetor (22) dhe e mërkurë për muajin dhjetor (18) të këtij viti. Ndërsa sa i përket orës së mbajtjes u vendos që për këtë vit të jetë ora 14.00.

4. Duke filluar nga pika e katërt e rendit të ditës mbledhjen e kryesoi Kryetari Lladrovci. Gjendja u vlerësua e qetë nga togeri i policisë së Drenasit Arsim Shala dhe shpjegoi se rasti i vjedhjes në Kishën e Llapushnikut paraqet rast vjedhje pa konotacione fetare. Në mbledhje u shpreh pakënaqësia që persona me numër të madh të veprave penale të kryera nuk janë dënuar dhe u rekomandua që policia me mekanizmat e vet të përcjellë personat e identifikuar dhe të veprojë me më vendosmëri ndaj kryesve të këtyre veprave.
   Të pranishmit u njoftuan se Komuna e Drenasit tani ka Zyrën e Sinjalizimit ku sekreti garantohet e edhe pse vlen për zyrtarët komunalë ka mundësi të bëhen edhe raportime të jashtme.

5. Për pikën e pestë të rendit të ditës në lidhje me qentë endacakë, raportoi Drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapi e cila tha se buxheti e për pasojë edhe veprimi ndaj kësaj dukurie është i centralizuar dhe inspektohet nga AVUK-u.

6. Sa i përket zjarreve, raportoi Drejtoresha për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Anita Avdullahu e cila tha se qytetarët duke menduar se po bëjnë pastrim të tokave ata në fakt po dëmtojnë tokën dhe ambientin. Për këtë çështje ajo tha se ka nevojë dhe rekomandoi për vetëdijesim të qytetarëve për këtë dukuri.

7. Për pikën e shtatë - të ndryshme- u rekomandua që policia gjatë hartimit të raporteve të aksidenteve t'i kushtojnë vëmendje vendit se ku ndodhin aksidentet dhe që njëkohësisht bashke me fotot e rastit të fotografojë edhe tabelat pranë vendit të aksidentit e po ashtu në rastet kur shohin se mungojnë tabelat ta njoftojnë komunën.

**Procesverbali aprovohet nga Kryetari:**
**Izveštaj odobrava Gradonačelnik:** **Ramiz Lladrovci**
nënshkrimi / potpis

**Data e aprovimit / Datum odobravanja:** **14/03/2018**

***Rekomandimet:***

- *Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;*
- *Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;*
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën:* mpb.dsb@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën:* Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.*